



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë /a/e:	26.02.2020
Referencë:	07-353/04-42785/20
Për / Za/ To:	EP Energy Plus.V.& Uniteti Global Alban e V & OJQ Ri-Jeta-Ferizaj
Nga/ Od/ From:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Kontrolloi:	Habib Qorri
Punoi:	Sabri Gashi
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Fatmir Mucolli dhe Arijeta Musliu nga Ferizaji, për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Skenderbeu".

Qëllimi i kërkesës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit -Ta ruajmë natyrën ta ruajmë shoqërinë. Stop Diskriminimit të qytetareve pa dallime
Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

Pëlqimin

Fatmir Mucolli dhe Arjeta Musliu për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin „Skenderbeu”.

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit -marsh paqësor për mbrojtjen e natyrës dhe diskriminimin e qytetareve

Organizimi i aktivitetit mbahet 01.03.2020 nga ora 12:00-13:00 në baze të axhendes së organizatorit, si dhe aktiviteti përmbyllet me datën 21.03.2020 pran Banerit që vendoset te sheshi „Skenderbeu”

Për mbajtjen e aktivitetit nuk nevojitet kurrfarë objekti shtese .

Pasi kemi dhe një aktivitet të njëjtë me date të njëjtë ju duhet të inkorporoheni me atë organizator që bashkërisht ta përruroni aktivitetin e nëse nuk keni një konfirmim pozitiv aktiviteti juaj duhet të shtyhet për 2 ore me vonë .

Organizatori obligohet që:

- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të këmbësorëve;
- të kujdesen mirë për pjesëmarrësit gjatë aktivitetit dhe të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës për sigurimin e aktivitetit .

- Te mos shpërndaj broshura që hedhen dhe krijojnë mbeturina .

- pas përfundimit të aktivitetit, hapësira të jetë e lirë si në gjendjen e mëparshme.

Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.